

Në pajtim me nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenin 65 dhe nenin 67, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 03/L209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L –150, Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2024, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PROCEDURAT E SHQIPTIMIT TË NDËSHKIMEVE ADMINISTRATIVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

Kjo rregullore përcakton procedurat që do t'i ndjekë Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (më tutje: BQK) në ushtrimin e kompetencave të saj, në lidhje me shqiptimin e ndëshkimeve administrative siç specifikohet në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (më tutje: Ligji për BQK-në) ose në ndonjë ligj apo akt tjetër juridik, që i jep BQK-së autoritet të shqiptojë ndëshkime administrative, përjashtimisht rasteve specifike kur Bordi Ekzekutiv i BQK-së vepron në bazë të nenit 67.5 të Ligjit për BQK-në

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me përkufizimet e përcaktuara në Ligjin për BQK-në dhe ligjet e tjera relevante apo akt tjetër juridik, që i jep BQK-së autoritet të shqiptojë ndëshkime administrative, ose siç përcaktohet me poshtë për qëllimin e kësaj Rregullore:

1.1. Njoftimi paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative – ka kuptimin e deklaratës e cila parashihet me nenin 67 paragrafi 4 të Ligjit për BQK-në, përmes së cilit institucioni financiar apo një subjekt tjetër i mbikëqyrur nga BQK, njoftohet me shkrim, me bazën ligjore të masave ndëshkimore administrative që mund të ndërmerren ndaj tij si rezultat i shkeljeve të kornizës ligjore dhe rregullative të konstatuara nga BQK-ja.

1.2. Raporti –ka kuptimin e dokumentit apo çfarëdo forme tjetër të komunikimit zyrtar të finalizuar nga departamenti apo divizioni përkatës i BQK-së, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre.

1.3. Person i autorizuar- është personi i cili në pajtim me legjislacionin në fuqi është i autorizuar nga institucioni financiar apo subjekti tjetër, për të përfaqësuar institucionin financiar apo subjektin në procedurën e rishqyrtimit.

Neni 3

Baza për dhënien e Njoftimit paraprak për shqiptim të ndëshkimeve administrative

Njoftimi paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative duhet të bazohet në raportet, që i hartojnë departamentet respektivisht divizionet përkatëse të BQK-së, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre.

Neni 4

Inicimi i procedurës për ndëshkim administrativ

1. Procedura e ndëshkimit administrativ iniciohet me Njoftimin paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative.
2. Njoftimi paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative përgatitet nga departamenti apo divizioni përkatës i BQK-së i cili duhet të mbështetet në konstatimet e evidentuara në raport dhe duhet të përshkruaj në mënyrë të detajuar faktet që mbështesin ekzistencën e shkeljeve të kornizës ligjore dhe rregullative.
3. Bordi Ekzekutiv i BQK-së e njofton subjektin të cilit do t'i shqiptohet ndëshkimi përmes Njoftimit paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative i cili i dërgohet në adresë të subjektit të cilit i drejtohet. Njoftimi në asnjë rast nuk mund të dërgohet tek subjekti para raportit të finalizuar nga departamenti apo divizioni përkatës i BQK-së.
4. Njoftimi paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative duhet të përmbajë këshillën juridike për të drejtën e subjektit, që brenda afatit prej 15 ditëve kalendarike nga data e pranimit të tij, mund të bëjë kërkesë për rishqyrtim tek Divizioni i Rishqyrtimit të Ankesave të Institucioneve Financiare në BQK, përmes së cilës do të ofrojë fakte dhe argumente se perse ndëshkimi nuk do të duhej t'i shqiptohej.

Neni 5

Zhvillimi i Procedurës

1. Nëse subjekti që ka pranuar njoftimin nuk ushtron të drejtën e kërkesës për rishqyrtim brenda afatit prej 15 ditëve të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 4 të kësaj rregulloreje, konsiderohet se subjekti është pajtuar me Njoftimin paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative. Në këtë rast drejtori i departamentit respektivisht udhëheqësi i divizionit të mëvetësishëm përgjegjës, që ka përgatitur njoftimin, brenda afatit prej 15 ditëve kalendarike do ta përgatitë dhe do ta dërgojë rekomandimin për vendimmarrje në Bordin Ekzekutiv, së bashku me sqarimin se subjekti të cilit i është dërguar njoftimi, nuk ka ushtruar të drejtën e kërkesës për rishqyrtim brenda afatit të paraparë kohor.
2. Nëse subjekti përkatës ushtron të drejtën e kërkesës për rishqyrtim, kërkesa duhet të përmbajë të gjitha argumentet mbi të drejtën e pretenduar sikurse edhe në rast të ushtrimit të kërkesës në instanca të tjera.
3. Divizioni i Rishqyrtimit të Ankesave të Institucioneve Financiare në afatin prej 30 ditëve kalendarike nga dita e pranimit të kërkesës, shqyrton kërkesën dhe përgatitë rekomandimin për vendimmarrje në Bordin Ekzekutiv.

4. Në rastet kur kërkesa për rishqyrtim e pranuar në Divizionin e Rishqyrtimit të Ankesave të Institucioneve Financiare është komplekse në përmbajtjen e saj dhe kërkon kohë me të gjatë të shqyrtimit, atëherë Divizioni i Rishqyrtimit të Ankesave të Institucioneve Financiare, mund të zgjasë afatin e shqyrtimit të kërkesës për aq kohë sa vlerësohet e nevojshme, por jo më gjatë se afati fillestar i përcaktuar me paragrafin 3 të këtij neni. Në rast të zgjatjes së afatit, Divizioni i Rishqyrtimit të Ankesave të Institucioneve Financiare do të njoftojë subjektin që ka ushtruar kërkesën për rishqyrtim.
5. Divizioni i Rishqyrtimit të Ankesave të Institucioneve Financiare me qëllim të shqyrtimit të fakteve dhe argumenteve, sipas nevojës mund të kërkojë sqarime dhe informata shtesë nga departamentet dhe divizionet përkatëse në BQK.

Neni 6

Procedura e seancës për rishqyrtim të kërkesës

1. Pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, Divizioni i Rishqyrtimit të Ankesave të Institucioneve Financiare gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, me kërkesë të palës si dhe në rastet kur e konsideron të nevojshme do t'i mundësojë subjektit përkatës të deklarohet gojarisht në seancën e organizuar lidhur me njoftimin.
2. Në qoftë se subjekti përkatës është ftuar në seancë sipas rregullit të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, ndërsa nuk përgjigjet për pjesëmarrje në seancën dëgjimore, atëherë Divizioni i Rishqyrtimit të Ankesave të Institucioneve Financiare do të vazhdoj procedurën e shqyrtimit të kërkesës edhe pa mbajtjen e seancës dëgjimore.
3. Divizioni i Rishqyrtimit të Ankesave të Institucioneve Financiare gjithashtu mund të vendosë për çështjen vetëm në bazë të kërkesës dhe provave të tjera të dorëzuara nga subjekti përkatës edhe pa e ftuar subjektin përkatës në seancë dëgjimore, nëse në bazë të shkresave mund të vijë deri te konstatimi i drejtë i gjendjes faktike.
4. Në qoftë se subjekti përkatës merr pjesë në seancën dëgjimore, atëherë atij/asaj do t'i mundësohet të deklarohet dhe të paraqesë çdo dokument në formë të dëshmisë, që e dëshmon të kundërtën e konstatimeve që janë specifikuar në Njoftimin paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative.

Neni 7

Përdorimi i gjuhëve në seancë

1. Procedura e rishqyrtimit në seancën dëgjimore zhvillohet në njëren gjuhë zyrtare të përcaktuar me Ligjin për gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, ndërsa subjekti ushtrues i kërkesës për rishqyrtim ka të drejtën, që në seancë dëgjimore ta përdorë gjuhën amtare.
2. Në rast se në seancën e thirrur, me kërkesë të BQK-së përdoret gjuhë tjetër nga gjuhët zyrtare atëherë BQK-ja do të sigurojë përkthyes.

Neni 8

Të drejtat ligjore të subjektit

Subjekti përkatës ka të drejtën e angazhimit të avokatit apo personit tjetër të autorizuar për ta përfaqësuar në procedurën administrative në BQK.

Neni 9

Rekomandimi dhe komunikimi për vendimmarrje

1. Pas përfundimit të veprimeve procedurale të nevojshme dhe atëherë kur konsiderohet se provat e administruara janë të mjaftueshme për të ardhur deri te rekomandimi pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, Divizioni i Rishqyrtimit të Ankesave të Institucioneve Financiare përgatit rekomandimin për Bordin Ekzekutiv konform nenit 5, paragrafi 3 ose paragrafi 4, të kësaj rregulloreje.
2. Procedura e rishqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim përfundon nga Divizioni për Rishqyrtim të Ankesave të Institucioneve Financiare me dërgimin e rekomandimit tek Bordi Ekzekutiv.
3. Rekomandimi i arsyetuar dhe i nënshkruar nga Udhëheqësi i Divizionit për Rishqyrtim të Ankesave të Institucioneve Financiare, dhe me konfirmim nga Departamenti Ligjor, përmes linjës përkatëse raportuese i dërgohet Bordit Ekzekutiv për vendimmarrje konform procedurës për dërgim të materialeve në Bordin Ekzekutiv të BQK-së. Një kopje e këtij rekomandimi i dërgohet edhe departamentit ose divizionit përkatës.
4. Departamenti ose divizioni përkatës i BQK-së përgatit Draft Vendimin për ndëshkime administrative, i cili së bashku me opinionin ligjor përkatës të Departmentit Ligjor dhe informacionin shoqërues, përmes linjës përkatëse raportuese, po ashtu i dërgohet Bordit Ekzekutiv për vendimmarrje konform procedurës për dërgim të materialeve në Bordin Ekzekutiv të BQK-së.

Neni 10

Procedura e nxjerrjes së vendimit për shqiptimin e ndëshkimeve administrative

1. Siç përcaktohet në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 dhe në nenin 67, të Ligjit për BQK në, Bordi Ekzekutiv pas analizimit të të gjitha rekomandimeve dhe raporteve të prezantuara, si dhe në pajtim me nenin 67, paragrafi 7, të Ligjit për BQK-në do të marrë vendim për shqiptimin e ndëshkimeve administrative.
2. Vendimi i Bordit Ekzekutiv për ndëshkime administrative, duhet të përmbushet nga subjekti të cilit i adresohet brenda afatit të dhënë në atë vendim.
3. Në rastin e një ndëshkimi administrativ që nuk është vërejtje me shkrim, BQK-ja do të marrë hapa të tjerë që janë të nevojshëm për të siguruar zbatimin e tij.
4. Çdo ndëshkim monetar do të paguhet në llogari të Buxhetit të Republikës së Kosovës.
5. Vendimi për shqiptimin e ndëshkimeve administrative duhet të jetë në përputhje me Ligjin e procedurës së përgjithshme administrative.

6. Vendimi për shqiptimet e ndëshkimeve administrative ndaj një personi juridik (institucioni), do t'i adresohet udhëheqësit të institucionit, ndërsa një kopje kryetarit të bordit të drejtorëve. Nëse personi juridik është institucion financiar i huaj, që vepron përmes një dege në Kosovë, vendimi do t'i adresohet menaxherit të lartë në Kosovë, ndërsa një kopje në gjuhën angleze udhëheqësit të institucionit në selinë qendrore të atij institucioni.
7. Vendimi për shqiptimin e ndëshkimeve administrative ndaj një personi fizik që është aksionar, anëtar i bordit të drejtorëve, menaxher i lartë ose punonjës i një institucioni financiar, do t'i adresohet personit fizik në fjalë dhe një kopje kryetarit të bordit të drejtorëve dhe udhëheqësit të institucionit. Nëse personi fizik është menaxher i lartë apo punonjës i një institucioni financiar të huaj, që vepron përmes një dege në Kosovë, kopja e vendimit do t'i adresohet personit fizik në fjalë, menaxherit të lartë në Kosovë dhe udhëheqësit të institucionit në selinë qendrore të atij institucioni.

Neni 11

Shkeljet e vazhdueshme ose të përsëritshme

1. Në rast se shkelja është e një natyre të vazhdueshme ose të përsëritshme, BQK-ja mund të shqiptojë ndëshkime administrative sipas përcaktimeve në nenin 67, të Ligjit për BQK-në dhe të ndonjë ligji tjetër që i jep BQK-së të drejtën e shqiptimit të ndëshkimeve administrative. Në rastet e ndëshkimeve monetare sipas paragrafit 3 të nenit 67 të Ligjit për BQK-në ato mund të shqiptohen në baza ditore për secilën ditë që shkelja vazhdon, përveç nëse ligji i aplikueshëm shprehimisht e parashih ndryshe.
2. Në rast të moszbatimit të urdhrit të përcaktuar me paragrafin 1 të këtij neni, BQK-ja do të ndër marrë masa të tjera detyruese, ashtu siç do të jetë e nevojshme për realizimin e detyrave që i janë besuar me Ligjin për BQK-në apo ndonjë ligj tjetër.

Neni 12

Publikimi

Bordi Ekzekutiv mund të vendosë të publikojë një vendim për shqiptimin e ndëshkimeve administrative kur vlerëson se është e nevojshme të njoftohet publiku.

Neni 13

Përgjegjësitë e tjera ligjore

Shqiptimi i ndëshkimeve administrative nga Bordi Ekzekutiv nuk e përjashton përgjegjësinë civile apo penale sipas dispozitave të ligjeve në fuqi.

Neni 14

Bashkëpunimi me autoritetet e huaja mbikëqyrëse

Nëse vlerësohet e nevojshme, BQK-ja mund të bashkëpunojë me bankat qendrore dhe autoritetet mbikëqyrëse në vendet e huaja, deri në masën e lejuar nga Ligji për BQK-në dhe ligjet e tjera, lidhur me shkëmbimin e informatave që kanë të bëjnë me shkeljen.

Neni 15

Mjetet juridike

1. Vendimi mbi shqiptimin e ndëshkimit administrativ është vendim përfundimtar në procedurën administrative.
2. Kundër vendimit mbi shqiptimin e ndëshkimit administrativ mund të ushtrohet padi në gjykatën kompetente në afatin e parashikuar ligjor.

Neni 16

Ligji i aplikueshëm

Për çdo çështje e cila nuk është e rregulluar në këtë rregullore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit të procedurës së përgjithshme administrative.

Neni 17

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për procedurat e shqiptimit të ndëshkimeve administrative e datës 29 nëntor 2019.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës